

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013
PERIUDHA 23.06.2013

**RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTIA
“EMIGRACIONI SHQIPTAR”**

Tirane më, 15 Shtator 2013

Tabela e përmbajtjes

RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet) PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë .

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013
PERIUDHA 23.06.2013

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë EMIGRACIONI SHQIPTAR për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë për periudhën 23.06.2013.

Pasqyra është përgjegjesi e drejtimit të subjektit zgjedhor Partia EMIGRACIONI SHQIPTAR .

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia EMIGRACIONI SHQIPTAR bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtimit – pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 “Konsiderata të vecanta – auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qellime specifike’. Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj e të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve , audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të Partisë në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare , me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme për rrethanat financiare, por jo me qëllimin që të shprehë një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partisë Demokristiane të Shqipërisë si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor Partia EMIGRACIONI SHQIPTAR është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.

Për mendimin tim, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë EMIGRACIONI SHQIPTAR e datës 23.06.2013, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimit dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

Silvana Gjikhima

Eksperte Kontabile e Rregjistruar

Tiranë , më 15.09.2013

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia EMIGRACIONI SHQIPTAR e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me urdher nr 39/1 DT 16.07.1998 Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë. Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj.

Subjekti zgjedhor Partia EMIGRACIONI SHQIPTAR eshte një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Partisë EMIGRACIONI SHQIPTAR eshte ne Tiranë.

Burimet e financimit janë :

- Buxheti i Shtetit financiar për fushatë 61.321 leke.

-Kuotat e antaresise jane (0) lekë.

- Te ardhura ndihma nga anetaret e Partise 95,600 leke

Burimet financiare jan përdorur drejtpërsëdrejti për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

a. Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,“ të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

a. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të Ardhurat.

Të ardhurat janë të pasqyruara mbi bazën e arkëttimeve të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partise EMIGRACIONI SHQIPTAR . Fondi 61.321 leke i dhene nga buxheti I shtetit eshte arketuiar ne bange. Ne arke jane arketuar 95,600 leke që janë dhurime nga anetarete partise konform rregullave të cilat tërësisht janë përdorur për fushatën zgjedhore të 23.06.2013.

Detyrimet, ose Shpenzimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Shpenzimet sipas analizes jane te pasqyruara te pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve ne Shumen 156,921 leke.

Të gjitha shpenzimet janë bërë nga arka dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare, megjithëse shumat e paguara janë më të vogla se kufiri i vënë nga organet fiskale dhe që nuk përbën shkelje. Do të ishte mirë që në të ardhmen veprimet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

Tiranë më, 15 shtator 2013

PARTIA "EMIGRACIONI SHQIPTAR"

PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE 23.06.2013

Përshkrimi	Lekë
A- Të Ardhurat	
Fondi financuar nga buxheti për fushatën zgjedhore	61,321
Total I te ardhurave nga kuota e antaresise	
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	95,600
Fonde të përftuara nga keshilltaret	
Totali të ardhurave, burimeve, (arkëtimeve)	156.921
B- SHPENZIME PËR FUSHATËN(deri më 23.06.2013)	0
1- Shpenzime per gjyqin ne apel	44,000
2- Shtypshkrime dhe kancelari	20,000
3- Udhetim e dieta	92,921
Total ii shpenzimeve	156,921
Diferenca	0

KRYETARI I PESH
Kostaq Papa

